



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**MINISTRIA E FINANCAVE**  
**DREJTORIA E PERGJITHSHME E DOGANAVE**  
**DEPARTAMENTI TEKNIK**

*Adresa: Rr. Durrësit, Laprake, Tirane / Tel: (0)4 2243922 / E.mail: s\_origjina@dogana.gov.al / Web: www.dogana.gov.al*

**Nr. 7589/2\_\_Prot.**

**Tirane, 21 /05 / 2013**

**RREGULLORE**

**Nr 01 Date 21.05.2013**

**“MBI EKSPORTUESIT E MIRATUAR”**

**1. PARIME TE PERGJITHSHME**

**Qellimi** : Drejtoria e Pergjithshme e Doganave me qellim zhvillimin e nje klime sa me te favorshme per operatoret ekonomike ne drejtim te lehtesimit te procedurave te leshimit dhe verifikimit te provave te origjines, reduktimin e kostove administrative dhe kohes te perpunimit te mjeteve ne dogane; mund te autorizojte dhenien e Statusit te Eksportuesit te Miratuar.

Dhenia e ketij statusi nenkupton qe kompanite te cilat plotesojne kriteret mund te eksportojne mallra duke i dhene atyre origjinen preferenciale me ane te shenimit perkates ne Faturen e leshuar prej tyre.

Ky Autorizim i mundeson kompanise vertetimin e origjines preferenciale te mallrave ne eksport nepermjet Deklarates Fature drejt vendeve anetare te Bashkimit Europian, vendeve te CEFTA 2006, vendeve te EFTA-s, Republikes se Turqise, si dhe vendeve me te cilat mund te zbatohen marreveshje te tregtise se lire ne te ardhmen.

**Baza ligjore**

**Ligji nr. 8449 date 27.01.1999** “Kodi Doganor i Republikes se Shqiperise” i ndryshuar”;

**MSA** (Ligj Nr. 9590, date 27.7.2006, “Per Ratifikimin e Marreveshjes se Stabilizim Asociimit ndermjet Republikes se Shqiperise dhe Komuniteteve Evropiane e Shteteve te tyre Anetare, publikuar ne Fletoren Zyrtare Nr. 87, date 14 Gusht 2006, faqe 2955) - Protokolli 4;

**Marreveshja e Tregtise se Lire te Evropes Qendrore CEFTA - 2006** (Ligj Nr. 9696, date 21.3.2007 “Per ratifikimin e “Marreveshjes per amendimin dhe aderimin ne Marreveshjen e Tregtise se Lire te Evropes Qendrore, botuar ne Fletoren Zyrtare Nr. 37, date 31.03.2007, faqe 709) - Protokolli 4;

**Marreveshja e Tregtise se Lire midis Republikes se Shqiperise dhe Turqise** (Ligj Nr. 9733, date 14.5.2007 “Per ratifikimin e Marreveshjes se Tregtise se Lire midis Republikes se Shqiperise dhe

Republikes se Turqise”, botuar ne Fletoren Zyrtare Nr. 66/1 date 08.06.2007, faqe 3 (ribotim i Fletores Zyrtare Nr. 66, date 08.06.2007, faqe 1775) - Protokolli 2,;

**Marreveshja e Tregtise se Lire midis Republikes se Shqiperise dhe shteteve EFTA** (Ligj Nr. 10288, date 17.6.2010 “Per ratifikimin e “Marreveshjes se Tregtise se Lire ndermjet Republikes se Shqiperise dhe sheteve EFTA dhe te marreveshjeve per bujqesine ndermjet Republikes se Shqiperise dhe Konfederates se Zvicres dhe Principates se Lihtenshtejnit, Republikes se Shqiperise dhe Mbreterise se Norvegjise dhe Republikes se Shqiperise e Republikes se Islandes si pjese perberese te saj dhe botuar ne Fletoren Zyrtare Nr. 91, date 17.07.2010, faqe 4633) - Protokolli 4 neni 23;

**Konventa Rajonale Pan-Euro-Mediane.** (Ligj Nr. 1, date 26.01.2012 “Per ratifikimin e konventes rajonale per Rregullat Preferenciale Pan-Euro-Mediane te Origjines”, botuar ne Fletoren Zyrtare Nr. 7 date 20.02.2012, faqe 197. Shtojca I.

## **2. PROCEDURA PER PAJISJEN ME STATUSIN E EKSPORTUESIT TE MIRATUAR**

1. Kompania depoziton nje kerkese me shkrim prane Drejtorise se Pergjithshme te Doganave/Departamenti Teknik per marrjen e Statusit, si dhe ploteson formularin tip te “Aplikimit per Statusin e Eksportuesit te Miratuar” sipas Aneksit 1 te kesaj Rregulloreje.
2. Formulari i Aplikimi mund te plotesohet direkt ne faqen web: [www.dogana.gov.al](http://www.dogana.gov.al), rubrika origjina/eksportuesi i miratuar.
3. Kerkeses i bashkengjitet dokumentacioni i kerkuar ne piken 6 te Aneksit 1, si dhe dokumentacioni shtese lidhur me argumentimin e perfitimit te origjines preferenciale te mallrave per te cilat aplikon per marrjen e ketij statusi.

## **3. KRITERET PER PERFTIMIN E STATUSIT TE EKSPORTUESIT TE MIRATUAR**

Kompania e cila aplikon per statusin e “Eksportuesit te Miratuar” duhet te plotesoje kriteret e meposhtme:

- a) Te kete eksportuar mallra me origjine preferenciale, me prove te origjines preferenciale per nje periudhe prej minimumi dy vjet nga data e kerkeses;
- b) Te mos kete patur asnje rast te kontestuar per provat e origjines te perdorura prej saj ne eksport nga Doganat homologe;
- c) Te kete nje frekuence prej minimumi 1 ngarkese per eksport ne muaj ose 12 eksporte ne vit.
- d) Te paraqese dokumentacionin e nevojshem per te vertetuar statusin e origjines se mallrave.
- e) Kompania aplikuese duhet te lejoje inspektimin e llogarive financiare si dhe cdo kontroll dokumetar dhe fizik qe konsiderohet i nevojshem nga autoritet doganore lidhur me provat e origjines.
- f) Ne momentin e aplikimit per marrjen e statusit te “Eksportuesit te Miratuar” te mos kete asnje detyrim doganor te papaguar.
- g) Kompania ka te punesuar te pakten nje punonjes qe ka njohuri mbi rregullat e origjines.

## **4. MIRATIMI I STATUSIT TE EKSPORTUESIT TE MIRATUAR**

1. Me marrjen e kerkeses dhe te formularit te aplikimit Drejtoria e Pergjithshme e Doganave kerkon mendim nga Dega Doganore mbikqyrese ose nga Dega e Doganes ne territorin e se ciles Kompania aplikuese ka seline e saj lidhur me aktivitetin tregtar te kompanise.
2. Dega Doganore pasi kryen verifikim dokumentar lidhur me aktivitetin eksportues te kompanise per mallrat me origjine preferenciale, jep opinionin e saj mbi aktivitetin e Kompanise, nese mund te miratohet dhenia e Statusit apo ka rezerva mbi te, duke paraqitur nje raport te detajuar mbi aktivitetin eksportues te Kompanise.
3. Sektori i Origjines prane Drejtorise se Pergjithshme te Doganave ne bashkepunim me doganieret e kontrollit pas zhdoganimit prane deges doganore perkatese, kryen kontroll dokumentar dhe fizik ne ambientet e prodhuesit/eksportuesit mbi zbatimin korrekt te Rregullave te Origjines lidhura me mallrat e kerkuara ne aplikim.
4. Neqoftese jane plotesuar te gjitha pikat e siperpermendura i jepet Statusi i Eksportuesit te Miratuar duke leshuar autorizimin.
5. Nese jo, kthehet pergjigje duke argumentuar arsyet.

## **5. NUMRI I EKSPORTUESIT TE MIRATUAR**

1. Eksportuesi miratuar pajiset me nje numer identifikues, i cili paraqitet ne shenimin e specifikuar ne fature.
2. Numri identifikues eshte i ndertuar si me poshte:  
AL/XX/XXXX/XX/XXXX:  
2 karakteret e para: Kodi i Shqiperi sipas ISO Alpha  
2 karaktere: Nr i autorizimit  
4 karaktere: Kodi i doganes mbikqyrese  
2 karaktere: Muaji  
4 karaktere: Viti i leshimit
3. Nje shenim jo i sakte i numrit te autorizimit ne deklaraten fature mund te çojë ne kerkesa per kontrole nga autoritetet doganore homologe dhe madje mund te sjelle edhe refuzimin e preferences nga vendi partner.

## **6. SHTRIRJA DHE VLEFSHMERIA E STATUSIT TE EKSPORTUESIT TE MIRATUAR**

1. Autorizimi i eksportuesit te miratuar lidhur me deklarimin e origjines preferenciale eshte i vlefshem per te gjitha eksportet ne vendet apo grupimet e vendeve me te cilat zbatohen marreveshje te tregtise se lire. Ky autorizim eshte i vlefshem per 2 vjet nga data e miratimit.
2. Ne rastet e hyrjes ne fuqi te nje marreveshjeje te re te tregtise se lire, Eksportuesi i Miratuar me qellim perfitimin nga statusi i ri preferencial ne vendin e ri partner, duhet te paraqese nje kerkese prane DPD per perfshirjen e ketij vendi apo grupi vendesh ne autorizim.

## **7. PERJASHTIMI NGA NENSHKRIMI**

Eksportuesi i Miratuar nuk eshte i detyruar te firmose deklaraten fature me kushtin qe ai t'i kete dhene autoriteteve doganore nje deklarate me shkrim ku ai pranon pergjegjesine e plote per çdo Deklarate

Fature, e cila identifikon atë si të ishte firmosur me dorë prej tij, duke plotësuar pikën 9 në formularin tip të "Aplikimit për Statusin e Eksportuesit të Miratuar" sipas Aneksit 1 të kesaj Rregulloreje. Perjashtimi i firmës përfshin gjithashtu edhe perjashtimin e shkruajtjes së emrit të vetë nënshkruesit.

## 8. NJOHJA E RREGULLAVE TE ORIGJINES

Lidhur me njohjen e rregullave të origjinës, kompania eksportuese duhet të sigurohet që personi përgjegjës të ketë njohuri mbi rregullat e origjinës, sepse vetëm atëherë garantohen detyrimet e eksportuesit.

## 9. DETYRIMET E KOMPANISE

1. Të sigurojë përdorimin e këtij Statusi vetëm për mallrat me Origjinë Preferenciale, të cilat i eksporton vetë ai;
2. Të sigurojë që Deklarata-Fature të jetë e plotë dhe e sakte sipas kushteve të Marrëveshjeve të Tregtisë së Lire në varesi të vendit ku do të kryhet eksporti. Në Deklaratë-Fature duhet të shenohet numri i identifikimit të autorizimit. Deklarata-Fature do të leshohet nga eksportuesi nëpërmjet shtypjes, stampimit apo printimit mbi fature apo çdo dokumenti tjetër tregtar të shenimit i cili jepet në anekset e marrëveshjeve:

- a. Për rastet kur eksportet janë drejt vendeve të **BE, EFTA dhe TR** teksti i përdorur në gjuhën shqipe duhet të jetë:

*"Eksportuesi i produkteve të përfshira në këtë dokument (autorizim doganor Nr..... (1)) deklaron që përveç rasteve kur tregohet qartësisht ndryshe, këto produkte janë me origjinë ..... preferenciale (2)."*

- b. Për rastet kur eksportet janë drejt vendeve **CEFTA**, teksti i përdorur në gjuhën shqipe duhet të jetë:

Eksportuesi i produkteve të përfshira në këtë dokument (autorizim doganor Nr..... (1)) deklaron që përveç rasteve kur tregohet qartësisht ndryshe, këto produkte janë me origjinë ..... preferenciale (2).

- kumulimi i zbatuar me ..... (emri i shtetit(eve) ose territorit(eve))
- jo kumulim i zbatuar (3).

.....<sup>4</sup>

(Vëndi dhe data)

.....<sup>5</sup>  
(Firma e eksportuesit, e shoqëruar me emrin i personit i cili nënshkruan deklaratën të shkruar me gërma të qarta)

-----  
(1) Kur deklarimi i faturës është bërë nga një eksportues i aprovuar, numri i autorizimit të eksportuesit të aprovuar duhet të shkruhet në këtë vënd. Kur deklarimi i faturës nuk është bërë nga një eksportues i autorizuar, fjalët në kllapa nuk janë të nevojshme të vendosen ose hapësira duhet të lihet bosh.

(2) Duhet të përcaktohet origjina e mallit.

(3) Plotësohet dhe fshihet kur është e nevojshme

(4) Këto të dhëna nuk janë të nevojshme të vendosen në rast se ky informacion përcaktohet në vetë dokumentin.

(5) Shiko nenin 22(5) të këtij protokoll. Në rastet kur eksportuesit nuk i kërkohet që të nënshkruajë, perjashtimi i firmës përfshin gjithashtu edhe perjashtimin e shkruajtjes së emrit të vetë nënshkruesit.

3. Te ruaje per te pakten tre vjet kopjet e Deklaratave Fature;
4. Te lejoje autoritet doganore te kryejne inspektim te llogarive financiare, dhe ti siguroje atyre kur eshte e nevojshme prova shtese.
5. Te njoftoje menjehere Drejtorine e Pergjithshme te Doganave per ndryshime ne proceset e prodhimit, lendes se pare te importuar apo kushteve te Rregullave te Origjines;
6. Ne fund te cdo viti (nga data e miratimit), duhet te paraqese prane Deges Doganore mbikqyrese nje raport informues lidhur me Deklaratat-Fature te leshuara per mallrat e eksportuara.
7. Te siguroje ndalimin e rimbursimit apo perjashtimin nga detyrimet doganore,te materialeve jo-origjinuese te perdorura ne prodhimin e produktit final origjinues ne Shqiperi.
8. Te siguroje qe transporti i mallrave me origjine preferenciale te jete i tille, qe te plotesoje kerkesat e transportit te drejtperdrejte.
9. Te mbaje pergjegjesi te plote per perdorimin e autorizimit.

## **10. RINOVIMI I AUTORIZIMIT**

1. Mbas mbarimit te afatit 2-vjeçar te ketij autorizimi, eksportuesit i lind e drejta te aplikojte serish per rinovimin e ketij autorizimi.
2. Me marrjen e aplikimit Sektori i Origjines i kerkon opinion Deges Doganore mbikqyrese lidhur me aktivitetin tregtar si dhe perdorimin e ketij autorizimi gjate aktivitetit eksportues te kompanise per mallrat me origjine preferenciale per periudhen perkatese 2-vjeçare.
3. Dega e Doganes pasi analizon veprimtarine mbi rregullshmerine e aktivitetit tregtar si dhe raportin vjetor te perdorimit te statusit te eksportuesit te paraqitur nga kompania (pika 9/6) paraqet nje raport te detajuar mbi aktivitetin eksportues te Kompanise si dhe shpreh opinionin e saj mbi lidhur me miratimin apo jo te rinovimit te Statusit te eksportuesit te miratuar.
4. Sektori i Origjines, pasi vlereson opinionin e deges doganore perkatese, dhe analizon historikun e kompanise ne data-bazen e sektorit te origjines, rinovon ose jo statusin e eksportuesit te miratuar.

## **11. REVOKIMI I AUTORIZIMIT**

1. Ne rastin kur Kompania nuk ploteson kushtet e nevojshme per perfitimin e Origjines Preferenciale Shqiptare, apo kur eshte bere nje shfrytezim jo-korrekt i ketij Autorizimi, Drejtoria e Pergjithshme e Doganave mund te revokojte Autorizimin ne çdo kohe.
2. Per prodhimin e informacionit jo-korrekt ne teksin e Deklarates Fature apo per shperdorimin e ketij Autorizimi, Kompania mban pergjegjesi dhe ndaj saj zbatohen sanksionet e parashikuara ne Kodin Doganor te RSH, Dispozitat Zbatuese te tij si dhe normave dhe angazhimeve nderkombetare.

## **12. DISPOZITA PERFUNDIMTARE**

1. Rregullorja e DPD nr. 01 date 14.07.2009 “Mbi statusin e Eksportuesit te Miratuar”


shfuqizohet.

2. Autorizimet e dhena ne zbatim te rregullores se Drejtorise se Pergjithshme te Doganave nr. 1 date 14.07.2009 "Mbi statusin e Eksportuesit te Miratuar" jane te vlefshme deri ne perfundim te afatit te vlefshmerise se tyre.

Kjo Rregullore hyn ne fuqi menjehere.

  
FLAMUR GJYMISHKA

DREJTOR I PERGJITHSHEM





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE  
DEPARTAMENTI TEKNIK  
DREJTORIA E TARIFËS DHE ORIGJINËS

Nr. 31827 Prot.

Tiranë më, 23 / 12 /2015

**TË GJITHA DEGËVE DOGANORE**

**DEPARTAMENTIT OPERATIV – HETIMOR**

**Lënda: Informacin mbi modelin e ri të Numrit të Autorizimit që lëshohet për Eksportuesit e Miratuar**

Në kuadër të përmirësimeve që i janë bërë sistemit kompjuterik “ASYCUDAworld”, nëpërmjet Urdhërit të DPD Nr. 24176 Prot datë 02.10.2015 kodet e Degëve Doganore kanë ndryshuar dhe janë bërë me 8 karaktere (AL000000), rrjedhimisht ka ndryshuar edhe modeli i Numrit të Autorizimit që do të lëshohen në të ardhmen për Eksportuesit tanë të Miratuar, si më poshtë:

**AL/15/010000/15:**

Dy gërma të kodit Iso Alpha të Shqipërisë (AL) / numri i autorizimit / kodi gjashtë shifror që identifikon Zyrën Doganore direkte përgjegjëse për kontrollin e eksportuesit të miratuar / viti i autorizimit (dy shifror).

Degët Doganore të informojnë Agjensitë Doganore që operojnë pranë tyre mbi këtë Urdhër.

**PRANVERA FAGU (BEHUSHI)**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

